REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.75, datë 20/12/2005

"PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "TË FESTOJMË SË BASHKU VITIN E RI"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 10, pika 3 (paragrafi II/c), neni 32, gërma "dh" dhe neni 72, pika 4 (paragrafi II/c), ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë shumën prej 300.000 lekë për projektin "Të festojmë së bashku Vitin e Ri".

2. Kjo shumë do të përballohet nga fondi i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005", nga zëri për Projekte Sociale.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI